

Albanian A: literature – Standard level – Paper 2
Albanais A : littérature – Niveau moyen – Épreuve 2
Albanés A: literatura – Nivel medio – Prueba 2

Tuesday 1 May 2018 (morning)

Mardi 1 mai 2018 (matin)

Martes 1 de mayo de 2018 (mañana)

1 hour 30 minutes / 1 heure 30 minutes / 1 hora 30 minutos

Instructions to candidates

- Do not open this examination paper until instructed to do so.
- Answer one essay question only. You must base your answer on at least two of the part 3 works you have studied and compare and contrast these works in response to the question. Answers which are not based on a discussion of at least two part 3 works will not score high marks.
- You are not permitted to bring copies of the works you have studied into the examination room.
- The maximum mark for this examination paper is **[25 marks]**.

Instructions destinées aux candidats

- N'ouvrez pas cette épreuve avant d'y être autorisé(e).
- Traitez un seul sujet de composition. En basant votre réponse sur au moins deux des œuvres de la troisième partie que vous avez étudiées, vous devez comparer et opposer ces œuvres dans le cadre du sujet. Les réponses qui ne sont pas basées sur au moins deux des œuvres de la troisième partie n'obtiendront pas une note élevée.
- Vous n'êtes pas autorisé(e) à apporter des exemplaires des œuvres que vous avez étudiées dans la salle d'examen.
- Le nombre maximum de points pour cette épreuve d'examen est de **[25 points]**.

Instrucciones para los alumnos

- No abra esta prueba hasta que se lo autoricen.
- Conteste una sola pregunta de redacción. Base su respuesta en al menos dos de las obras estudiadas de la parte 3, comparándolas y contrastándolas en relación con la pregunta. Las respuestas que no se basen en al menos dos obras de la parte 3 no recibirán una puntuación alta.
- No está permitido traer copias de las obras estudiadas a la sala de examen.
- La puntuación máxima para esta prueba de examen es **[25 puntos]**.

Përgjigjuni vetëm **një** pyetjeje. Duhet të bazoni përgjigjen tuaj në **të paktën dy** nga veprat e pjesës 3 që keni studiuar dhe **krahasoni dhe dalloni** këto vepra duke iu përgjigjur pyetjeve. Përgjigjet që **nuk** bazohen në veprat e pjesës 3 **nuk** do të marrin nota të larta.

Poezi

1. Duke iu referuar së paku dy prej poetëve që keni studiuar krahasoni teknikat që përdorin ata për të lidhur në poezi përvojat vetjake me idetë përgjithësuese.
2. Poezia është gjuhë që gjithmonë thotë më shumë nga sa duket. Duke iu referuar gjerësisht të paktën dy poetëve që keni studiuar, flisni rreth krijimit dhe efektshmërisë së niveleve të shumta të kuptimit të poezive.
3. Analizoni efektin e poezive me një skemë rime dhe/ose pa një skemë të tillë. Trajtoni efektet specifike që arrihen tek të paktën dy prej poetëve që keni studiuar.

Teatër

4. Duke qenë se lejon përballjen e personazheve nga shtresa të ndryshme sociale, teatri frymëzohet nga konflikti politik. Përligjini vlefshmërinë e këtij pohimi duke krahasuar së paku dy vepra, të cilat i keni studiuar.
5. Duke marrë si shembull të paktën dy vepra që keni studiuar diskutoni mënyrën sesi i përdorin dramaturgët efektet e dritave dhe tingujve për të arritur efekte të ndryshme.
6. Duke iu referuar posaçërisht së paku dy pjesëve teatrore që keni studiuar analizoni mënyrat e ndryshme sesi janë përdorur udhëzimet skenike dhe funksionet e ndryshme që kanë ato në një pjesë teatrore.

Esé

7. Deri në ç'masë ofron zgjidhje mënyra sesi përfundon një esé? Diskutojeni dhe krahasojeni këtë në të paktën dy vepra që keni studiuar.
8. Komentoni rreth teknikave bindëse të autorëve në të paktën dy esé që keni studiuar.
9. Duke përdorur si shembuj të paktën dy esé që keni studiuar trajtoni si dhe me ç'efekte përdoren stereotipet në to.

Prozë

10. Krahasoni mënyrën sesi të paktën dy shkrimtarë që keni studiuar përdorin kontekstet urbane dhe/ose rurale në veprat e tyre.

 11. Të dhënit e një morali apo mësimi është një nga veçoritë e pranuarra gjerësisht për zhanrin e prozës. Në ç'mënyra dhe për ç'qëllime i mbahen kësaj bindjeje apo bien ndesh me të, të paktën dy nga autorët që keni studiuar?

 12. Duke iu referuar së paku dy veprave që keni studiuar krahasoni mënyrën sesi zbulojnë personazhet identitetin e tyre dhe si ndikon ky zbulim tek veprat si e tërë.
-